



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-769/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>04.03.2014</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.03.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3299/13, për z. Hashim Deshishku – Deputet në Kuvendin Republikës së Kosovës, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3299/13, për zyrtarin e z. Hashim Deshishku – Deputet në Kuvendin e Kosovës dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesin privat “Gazetë e Përditshme Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Deshishku, është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, vullnetarisht ka hequr dorë nga pozita e bashkëpronarit në biznesin e lartpërmendur privat për të vazhduar ushtrimin e funksionit publik si deputet i Kuvendit të Kosovës.

z. Dëshishku, brenda afatit ligjor, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 685/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka është larguar nga pozita e bashkëpronarit në biznesin privat “Gazetë e Përditshme Prishtina”.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

